



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



OFRIMI I NDIHMËS EKONOMIKE NË NIVEL VENDOR

Çfarë është Ndihma Ekonomike?

Ndihma ekonomike është një pagesë në para që u jepet familjeve/individëve të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike. Ndihma ekonomike *e plotë* iu jepet familjeve në nevojë që nuk kanë asnjë lloj të ardhure, ndërsa ndihma ekonomike *e pjesshme* iu jepet familjeve të cilat përfitojnë të ardhura të pamjaftueshme nga burime të tjera (toka, pensionet etj).



Roli i Njësive të Qeverisjes Vendore në ofrimin e shërbimeve shoqërore

- Njësitë e qeverisjes vendore ndihmojnë grupet në nevojë nëpërmjet shpërndarjes së burimeve ekonomike që kanë në dispozicion;
- Shërbimet shoqërore që ofron bashkia janë në formën e ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë, shërbime të përkujdesit social, rezidencial dhe komunitar;
- Bashkia harton sistemin e integruar të ndërhyrjeve për shërbimet sociale;
- Shërbimi social në Bashki koordinon administrimin e të gjitha burimeve duke iu përgjigjur kërkeseve sociale.



Kategoritë e subjekteve që përfitojnë nga ndihma ekonomike janë:

- a. Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
- b. Jetimët mbi 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari;
- c. Prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
- d. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;
- e. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;
- f. Fëmijë të vendosur në shërbimin e kujdestarisë.

Materialet informuese janë përgatitur nga ekspertët e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) në kuadër të iniciativës me temë “Monitorimi dhe përmirësimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale në nivel vendor (Tiranë, Fier, Berat, Pogradec)”, me mbështetjen e United States Agency for International Development (USAID). Opinionet e shprehura në këtë material nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e United States Agency for International Development (USAID)



Ku dhe kur aplikohet për ndihmë ekonomike?

Për përfitimin e ndihmës ekonomike aplikohet pranë njësisë vendore të vendbanimit;

Për të përfituar ndihmë ekonomike, kryefamiljari, së bashku me bashkëshorten, nga data 1-10 të çdo muaji paraqiten pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/njësitë për të aplikuar për ndihmë ekonomike



Procedura e aplikimit

- ✓ Administratori shoqëror, në prani të kryefamiljarit, bashkëshortes apo individëve plotëson në sistem aplikimin për ndihmë ekonomike të cilët përmbledhin informacionin për demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin, llojin e banesës, pasuritë familjare, të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhura të tjera.



Është me shumë rëndësi që informacioni tè jetë i saktë, pasi në rast tè kundërt penalizohen familjet për deklarim tè rremë.

- ✓ Lista e familjeve aplikante verifikohet automatikisht nga sistemi elektronik dhe vendimi merret brenda muajit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror nëpërmjet formulës së pikëzimit.

Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit

- Çdo qytetar që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë apo interesat e ligjshëm nga veprimet/mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike mund ti drejtohet Avokatit të Popullit;
- Institucionit të Avokatit të Popullit mund ti drejtoheni nëpërmjet kërkesës, ankesës dhe njoftimit. Për to nuk kërcohët ndonjë formë e caktuar por duhet të shprehin qartë objektin e ankimit ose të kërkesë dhe të mos jenë anonime.



Ku dhe si mund të ankoheni ndaj refuzimit të dhënies së ndihmës ekonomike?

Familjet të cilat janë refuzuar se nuk kanë marrë pikët e mjafueshme kanë të drejtën e riaplikimit në muajt pasardhës dhe gjithashtu ruajnë të drejtën e ankimit në lidhje me vendimin e marrë;

Ankimi bëhet me shkrim brenda 10 ditëve, fillimisht pranë njësisë vendore e cila është e detyruar të kthejë përgjigje brenda 7 ditëve nga marrja e ankesës;

Qytetari ka të drejtë të ankohet brenda 10 ditëve te Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror e cila gjithashtu njofton me shkrim qytetarin dhe njësinë e qeverisjes vendore brenda 10 ditëve të punës;

Qytetari gjithashtu mund të ngrëjë padi në gjykatë, referuar ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative;

Së fundmi, mund ti drejtohet me një ankesë, kërkesë dhe njoftim Institucionit të Avokatit të popullit.

Për çdo informacion shtesë lidhur me këto shërbime, ju mund ti referoheni faqeve web të bashkive përkatëse si dhe në linket e mëposhtme:
www.portavendore.al info@sherbimisocial.gov.al

Ju mirëpresim në forumet dhe diskutimet tonë



www.altri.al



qendra.altri@gmail.com / info@altri.al



Qendra ALTRI



Qendra ALTRI